DOCENT / TITULLIN SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR SHKENCOR**

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Suksesi mesatar në ciklin e parë: ____/____ Suksesi mesatar në ciklin e dytë: ____/____ Suksesi mesatar ____/____ për studimet e integruara.	PO
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore e shkencave mjekësore Lëmia - Biomedicinë Emri i sferës shkencore: Oftalmomogji, fushës Oftalmologji, degës Oftalmomolgji.	PO
3	<ol style="list-style-type: none">1. Nadi Rustemi ¹, Rezultatet e terapise medikamentoze dhe kirurgjikale ne trajtimin e glaukomes ne Kliniken e Syve ne Prishtine. Medicus 2008; (3):212 UDK: 61, ISSN 1409.2. Nadi Rustemi, Rexhep Abdiu, . Dakrocistorinostomia me tuba silikon ne tratimin e dakrocistitit, 2009;8(2):165-167. UDK: 11, ISSN 1857-5587.3. Nadi Rustemi , Ilaz ismaili, Emilija Gashevska Dashtevska, Gazmend Kaqaniku, The treatment of Dabetic tarakte metodom fakoemulzifikacije u Klinickoj Bolnici u Tetovo, Republika Makedonjia- XVII Kongres Oftalmologa Srbije, 44: 2016.4. Mladen Bila, Nadi Rustemi, Ivan Stefanovic, Ultrasound Diagnostics of non-inflammatory optic nerve papilloedema XVII Kongres Oftalmologa Srbije 2016.	

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3.1	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, e cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: Medicus 2008 2. Emri i bazës elektronike të revistave: ISSN 1409 3. Titulli i punimit: Rezultatet e terapise medikamentoze dhe kirurgjikale ne trajtimin e glaukomes ne Klinikën e Syve ne Prishtine 4. Data e publikimit: 2008 	

Shtojcë

I raportit recenzues për zgjedhjen - rizgjedhjen e mësimeve në të gjitha thirjet mësimore - shkencore në fushën e Neurokirurgjisë (30219) dhe të tjera (30225)

Kandidati: Mr.Sci.Dr. Nadi Rustemi

Institucioni: Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lënda akademike: Shkenca Mjekësore OFTALMOLOGJI (30219) dhe të tjera (30225)

Veprimtaria mësimore-shkencore

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1.1		
	Oftalmologji 2009 ,8 ore-	8x15x0.03 x1 =3.6
	Oftalmologji 2010,1 3 ore	2x15x0.04 x3 =3.6

1.2	Oftalmologji prej 2013 , 2 ore-INFERMERI-4 vite	2x15x0.04 x4=6.45
1.3	Oftalmologji 2014, 2 ore,3 vite	2x15x0.04 x3 =3.6
1.4	Mesim Praktik- Ushtrime, prej 2015 , prej 2016,2017,2018,2019,2020,2021,2022 ,3 Ore	2x15x0.04 x3 =3.6
1.5	Mesim Praktik-Ushtriime , prej 2016,2017,2018,2019,2020,2021,2022 , 3 Ore	2x15x0.04 x3 =3.6
	Konsultime me studentë	
	320 studente	320x0.2=65.65
Gjithsej		90.10

Nr. Rendor	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikë
1.	Punimet me rezultatet shkencore origjinale, të botuara në revistën shkencore/profesionale referente me këshill redaktues ndërkombëtar/7	
	<p>1. Nadi Rustemi ¹,Rezultatet e terapise medikamentoze dhe kirurgjikale ne trajtimin e glaukomes ne Klinikën e Syve ne Prishtine.Medicus 2008; (3):212 UDK: 61, ISSN 1409.</p> <p>2. Nadi Rustemi, Rexhep Abdiu, . Dakrocistorinostomia me tuba silikon ne tratimin e dakrocistitit, 2009;8(2):165-167. UDK: 11, ISSN 1857-5587.</p> <p>3. Nadi Rustemi , Ilaz ismaili, Emilija Gashevska Dashtevska, Gazmend Kaqaniku, The treatment of Dabetic tarakte metodom fakoemulzifikacije u Klinickoj Bolnici u Tetovo, Republika Makedonjia- XVII Kongres Oftalmologa Srbije, 44: 2016.</p> <p>4. Mladen Bila, Nadi Rustemi, Ivan Stefanovic, Ultrasound Diagnostics of non-inflammatory optic nerve papilloedema XVII Kongres Oftalmologa Srbije 2016</p> <p>5. Takimi i katërt vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca, Tetovë, 31 Gusht deri 02 Shtator 2009: „Rezultatet e terapisë medikamentoze dhe operative të glaukomës së trajtuar në Klinikën e Syve në Prishtinë,,.</p>	<p>5</p> <p>4.8</p> <p>3.6</p> <p>3.8</p> <p>5</p>

	6. Ultrayvucni nalay kod neyaljenskog edema papile vidno zivca. Nadi Rustemi, Ivan Stefaovic. Acat Ophthalmologica Srbi, 2017.	5		
	7. Ultrasonnd diagnostics of non inflsmmatory optic nerve papilloedema Nadi Rustemi, Ivan Stefaovic. Acat Ophthalmologica Srbi, 2017.	5		
	8. Vitrektomija kod ablacije retine sa prpliferativnom vitroretinopatijom, problem perproliferacije. Nadi Rustemi, Ivan Stefaovic. Acat Ophthalmologica Srbi, 2017.	5		
GJITHSEJ NGA VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE				37.2

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikët
2	<p>Anëtar i Kryesisë së punës të sesionit (prezantime gojore) në Kongresin e 1-rë gjithëshqiptar të mjekeve me pjesëmarrje ndërkombëtare. 3-4 Qershor 2016 Tetove</p> <p>Kryeshef në Repartin e Syve pranë Spitalit Klinik të Tetovës prej 2012 deri me tani.</p> <p>Specializim Oftalmologji 2003-2007</p>	3
		1

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikët
3	Anëtar i këshillit organizativ ose programor të konferencës	3

	shkencore/profesionale ndërkombëtare - Kongresi gjithëshqiptar i Oftalmologëve me pjesëmarrje ndërkombëtare, 3-4 Qershor 2016 Tetove	
	Pjesëmarrja në komisione dhe në forume të organeve shtetërore dhe të organeve të tjera Anëtar i Shoqates së Mjekëve Shqiptare të Maqedonisë së Veriut (prej vitit 2010 e deri me tani)	3
GJITHSEJ VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË		10

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR T'U ZGJEDHUR NË TIUTLL	PIKË
VEPRIMTARIA EDUKATIVE MËSIMORE	90.10
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE-	37.20
GJITHSEJ NGA VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE NGA VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	10
GJITHSEJ	137.3

Veprimtaritë me interes të përgjithshëm

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN E THIRJES MESIMORE	
AKTIVITET MËSIMORE SHKENCORE	90.10
AKTIVITET KËRKIMORE SHKENCORE	137.3
AKTIVITET PROFESIONALE APLIKATIVE	10
TOTALI	237.4

KOMISIONI RECENSUES

Prof.Dr.Gazmend Kaçaniku _____ (kryetar)
 Prof.Dr.Afrim Shabani _____ (anëtar)
 Prof.Dr.Kastriot Haxhirexha _____ (anëtar)

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT NË TË GJITHË TITUJT MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMINË GJINEKOLOGJI DHE AKUSHERI (30205 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT), NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKSORE – UNIVERSITETI I TETOVËS, TETOVË

Në bazë të nenit 110 dhe 173 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 82/2018,,)nenit 252 dhe 254 të Statutit të Universitetit Të Tetovës dhe në përputhje me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në bazë të Propozimit të këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në lidhje me konkursin për zgjedhje – rizgjedhje të mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës të shpallur me datë 16.11.2022 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat”, si dhe në web-faqen e Universitetit të Tetovës www.unite.edu.mk, këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore, UT-Tetovë në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2022 solli vendimin Nr. 22-4383/1, më 14.12.2022 për formimin e komisionit recensues për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmin **Gjinekologji dhe Akusher** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florin Besimi (kryetar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës
- 2. Prof. Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës
- 3. Doc. Dr. Meral Rexhepi (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

Në konkursin e shpallur për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësit në të gjithë titujt mësimore-shkencore në afatin e paraparë është paraqitur kandidati:

D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.

Pas shqyrtimit të materialeve (dokumenteve) të dorëzuara, komisioni recensues ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore – Universiteti i Tetovës - Tetovë, t’ia paraqesë këtë:

R A P O R T

Në konkursin e shpallur për zgjedhjen e një mësime dhënësi në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore në lëminë **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmime shkencore hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afat të parashikuar është paraqitur kandidati:

D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.

Kandidati **D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.**, ka dorëzuar dokumentacionin e kompletuar të paraparë në konkurs.

1. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI

NAGIP Jusuf RUFATI

SHKOLLIMI DHE EDUKIMI

1986, Shkolla Fillore “Zufer Musiq”, Tetovë

1990, Shkolla e Mesme Komunale e Mjekësisë “Nikolla Shtejn”, Tetovë

2000, Fakulteti i Mjekësisë, Shkup

2008, Specjalist i gjinekologjisë dhe obstetrikës, Fakulteti i Mjekësisë, Shkup

2016, Regjistrim në studimet e Doktoraturës pranë Fakultetit të Mjekësisë në Tetovë,

2018, Fiton titullin Primarius nga Ministria e Shëndetësisë

2022, Doktor i Shkencave të Mjekësisë – në fushën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës, Fakulteti i Mjekësisë Tetovë

2. ARRITJET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE SI DHE ARRITJET E TJERA TË KANDIDATIT, QË NGA ZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E PARAQITJES

Veprimtaria shkencore-arsimore

Në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, kandidati **D-r. sc. Nagip Rufati D-r. spec.** mban mësim praktik dhe teorik (mësimdhënie, ushtrime, mësimdhënie në terren, etj.) në ciklin e parë të studimeve në të gjithë programet studimore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Është mentor i shumë temave të diplomës si dhe mentor i temave studentore të prezantuara në kongreset studentore të Republikës dhe një numër i madh praktikantësh të cilët e kanë kryer praktikën. Në viti 2011 zgjidhet në thirrjen shkencore **asistent** në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës. Nga angazhimi në UT në mënyrë aktive punon për edukimin e studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, duke kryer ligjërata dhe ushtrime në lëndët:

- Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme – praktika),
- Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme - praktika),
- Planifikim Familjar (Infermieri),
- Embriologji dhe zhvillimi i fetusit (Akushi),
- Gjinekologji (Praktika),

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen-rizgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati **D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.** në këtë veprimtari mësimore-arsimore ka një sere aktivitetesh të cilat janë prezantuar ne formularin e tabelave me pike.

Veprimtaria shkencore-kërkimore/veprimtaria profesionale-artistike

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore.

Për konkursin aktual i ka paraqitur punimet vijues për recension:
Punime shkencore me rezultate origjinale shkencore, të botuara në revista shkencore me këshill drejtues ndërkombëtar:

- *Mbrojtje e disertacionit të doktoraturës me temë “Identifikimi i citomegaloviruseve dhe toksoplazmave tek femrat si shkaktarë kryesor të aborteve dhe sterilitetit primar”, 2022*
- *Hiperplazioni i zemrës së majtë me atrezion të Aortës – Medicus 2011*
- *Big Baby Syndrome, Sfidë Akusherike – Revista Shqiptare Obstetrike dhe Gjinekologjiken 2015*
- *Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women - – 2nd International Scientific conference of the faculty of medical sciences, Health care challenges of the 21st century – 2017*
- *Abortion rates in Tetovo region from January 2012 to June 2017; Comparative study of data from district health authorities – Universi 2017*
- *Ndikimi i Citomegalovirusëve CMV, IgG, IgM, Toksoplazmozave TXM dhe TXG si shkaktarë potencial të sterilitetit dhe aborteve tek gratë shtatëzëna – Takim Profesional i 22 Mjekësor, 2017 Strugë*

- *Infections during pregnancy with cytomegaloviruses – Takim Profesional i 22 Mjekësor, 2017 Strugë*
- *Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women – Acta Medica Balkanika 2018*
- *Prevalence of primary sterility and abortions as a result of viral and bacterial infections – Universi 2019*

- *Anëtar i komisioneve me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës në FSHM në UT*
- *Mentor i mbrojtjes të punimeve të diplomës në FSHM të UT.*

Veprimtaria profesionale – aplikative dhe vepremtaria me interes më të gjërë

Kandidati **D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.** është i përfshirë në mënyrë aktive në punimet seminarike, kurseve edukative dhe kurseve në takime profesionale dhe seksionesh. Poashtu në këtë veprimtari ka një sërë aktivitete dhe procese profesionale-aplikative, të cilat janë prezantuar në formularin e tabelave me pikë.

Aktivitet të veçantë kandidati tregon në veprimtaritë me interes më të gjërë:

- *Specializim i kryer në fushën e shkencave të mjekësisë dhe shëndetësisë 2008*
- *Kryetar i degës Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë të Maqedonisë, 2009-2013*
- *Anëtar i Këshillit drejtues pranë Klinikës Universitare “Torakale” Shkup 2009-2013*
- *Kryeshef i repartit Gjinekologjisë – Akusherisë pranë Spitalit klinik Tetovë, 2012 – e deri më sot*
- *Anëtar i këshillit të Shoqatës së Obstetërve të RMV*
- *Kryetar i këshillit drejtues pranë Spitalit Klinik Tetovë, 2013 - 2020*
- *Anëtar i Kuvendit, anëtar i Bordit Udhëheqës, si dhe ligjërues i akredituar për ligjërim të ndihmës së parë pranë Kryqit Kuq Tetovë; 2018 e deri më sot,*
- *Anëtar i komisionit për pushime mjeksore pranë Fondit Shëndetsor Tetovë 2018-deri më sot*
- *Kryetar i trupit koordinues në implementimin e programës për përkujdesje perinatale 2022*
- *Primarius*
- *Konsulent i UNFPA*
- *Pjesëmarës i projekteve të Fondit për popullatë i Kombeve të Bashkuara, prej vitit 2018, në planifikimin dhe implementimin të aktiviteteve nga Programi i UNFPA 2016-2020*

- *Partneriteti i UNFPA me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për uljen e vdekshmërisë amtare dhe neonatale (2018), bashkëpunim ky që vetëm brenda një vitit vdekshmërinë neonatale e uli më shumë se një të tretën. D-r. Rufati është marrë me projektimin dhe kryerjen e trajnimeve, përpilimin e protokoleve republikane për kujdesin efektiv perinatal dhe antenatal, veçanërisht për pjesën që iu referua Spitalit klinik në Tetovë. Me këtë trajnim, ekipet multidisciplinore nga gjinekolog/obstetër, neonatolog dhe mami u trajnuan sipas protokoleve dhe standardeve të Organizates Botërore Shëndetësore*
- *Monitorimi i maternitetit për zbatimin e rekomandimeve dhe procedurave të prezantuara me trajnimin për kujdes efektiv perinatal, me qëllim promovimin e shëndetit të nënës dhe të porsalindurit (2019).*
- *Krijimi dhe futja e një sistemi kombëtar për mbikëqyrjen dhe reagimin në obstetrikë, si pjesë iniciuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për shëndetin e nënës (2019-2020).*

KONKLUDIM DHE PROPOZIM

Duke u bazuar në tërë dokumentacionin e paraqitur dhe duke e analizuar veprimtarinë e deritanishme të përgjithshme të kandidatit nga gjitha e thëna më sipër, mund të shihet qartë vija e lartë e ngritjes të zhvillimit profesional të kandidatit **D-r. sc. Nagip Rufati Dr. Spec**, komisioni recenzues e çmon pozitivisht dhe e vlerëson veprimtarinë mësimore-arsimore, kërkimore-shkencore dhe profesionale-aplikative, si dhe veprimtarinë me interes më të gjerë. Në bazë të dhënave të paraqitura të veprimtarisë së përgjithshme të kandidatit, Komisioni konkludoi se **D-r. sc. Nagip Rufati Dr. spec.** posedon cilësi shkencore dhe profesionale dhe sipas Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullores për kriteret dhe për procedurën e zgjedhjes në titullin mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në tituj bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në titullin **docent** në lëminë e **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmime shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Sipas kësaj që u tha më lartë, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, pranë Universitetit të Tetovës, **Dr. sc. Nagip Rufati D-r. spec.** të zgjidhet në titullin **docent** në lëminë e **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmime shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

26.12.2022, Tetovë

KOMISIONI I RECENSENTËVE

1. **Prof. Dr.Florin Besimi (kryetar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

2. **Prof. Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

3. **Doc. Dr. Merale Rexhepi (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË,
SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: *Nagip Jusuf Rufati*

(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni: *Fakulteti I Shkencave Mjeksore*

(Emri i fakultetit/institutit)

Fusha shkencore: *BIOMEDICINE*

**KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR –
DOCENT / TITULLIN SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR SHKENCOR**

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Suksesi mesatar në ciklin e parë: 7.65 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 10 Suksesi mesatar 8.825 për studimet e integruara.	
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: <u>Mjekesi</u> , fushës: <u>BIOMEDICINE</u> , degës: <u>Gjinekologji-akushi</u>	
3	Të publikuara së paku katër punime shkencore* në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje.	

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3.1	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, e cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: <u>MEDICUS</u> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: <u>ISSN 1409-6366</u> 3. Titulli i punimit: <u>Hiperplazioni i zemrës së majtë me atrezion të Aortës</u> 4. Data e publikimit: <u>01.06.2011</u> 	
3.2	<p>Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç’rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t’i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: <u>UNIVERSI</u> 2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): <u>14, MK(4), AL(1), D(1), RKS(1), SW(1), CRO(1), F(1), IT(1), USA(1)</u> 3. Titulli i punimit: <u>Abortion rates in Tetovo region from January 2012 to June 2017; Comparative study of data from district health authorities</u> 4. Data e publikimit: <u>01.12.2017</u> 	
3.3	<p>Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe e cila publikohet në shtetin anëtar i Bashkimit Evropian/ose OBZHE</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: <u>ACTA MEDICA BALKANICA</u> 2. Emri i anëtarit të BE/OBZHE: <u>TILMAN DRUEKE (France)</u> 3. Titulli i punimit: <u>Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women</u> 4. Data e publikimit: <u>2018</u> 	
3.4	<p>Përbledhja e punimeve shkencore të recensuara, të prezantuar në tubime shkencore ndërkombëtare, ku anëtarët anëtarët e programit ose këshillit shkencor janë nga së paku tre shtete</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Titulli i përmbledhjes: <u>2nd INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE OF THE FACULY OF MEDICAL SCIENCES</u> 	

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	<p>2. Emri i tubimit ndërkombëtar: <u>HEALTH CARE CHALLENGES OF THE 21st CENTURY</u></p> <p>3. Emrat e shteteve: RM, USA, SWISS, ALBANIA.</p> <p>4. Titulli i punimit: <u>Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women</u></p> <p>5. Data e publikimit: <u>13-14.10.2017</u></p>	
3.5	<p>Përkthime të veprave kapitale në fushat të cilat i përcakton Këshilli kombëtar i arsimit të lartë dhe veprimtaria kërkimore-shkencore</p> <p>1. Titulli i veprës kapitale të përkthyer: <u>Prevalence of primary sterility and abortions as a result of viral and bacterial infections</u></p> <p>2. Data e publikimit: <u>02.05.2019</u></p> <p>3. Botuesi, vendi dhe viti i botimit: <u>International association for education, science, technology, innovation, healthand environment – UNIVERSI; TETOVO, 2019</u></p>	

F O R M U L A R – I A P L I K I M I T

TË RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË TITULL MËSIMOR -SHKENCOR, SHKENCOR, MËSIMOR-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTOR

Kandidati: **NAGIP Jusuf RUFATI.**

Institucioni: **UT-Tetovë, FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE – Tetovë**

Lëmia shkencore: **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

VEPRIMTARIA MËSIMORE -ARSIMORE

Nr. rend	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikë
1.	Mbajtja ligjërata dhe ushtrimeve (laboratorike, klinike, auditoriale ose përpilim i punimit seminarik)	72.00
1.1	Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 3x15x0.04x7	12.6
1.2	Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 3x15x0.04x7	12.6
1.3	Gjinekologji klinike (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 8x15x0.04x8	38.4
1.4	Embriologjia dhe zhvillimi i fetusit (Akushi) 2x15x0.04x4	4.8
1.5	Planifikim familjar (Infermieri) 2x15x0.04x3	3.6
2.	Konsultime me studentë	2.2
2.1	Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 0.002*7*50	0.7
2.2	Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 0.002x7x50	0.7
2.3	Gjinekologji klinike (Mjekësi e përgjithshme - praktika) 0.002x4x40	0.32
2.4	Embriologjia dhe zhvillimi i fetusit (Akushi) 0.002x4x30	0.24
2.5	Planifikim familjar (Infermieri) 0.002x3x40	0.24
3.	Mentor dhe anetar për mbrojtjen e temës në ciklin e parë Tema 6 x 0.2	1.2
4.	Përgatitja e lëndëve të reja-ligjërata	3.00
4.1	Planifikim familjar (Infermieri)	1.00
4.2	Embriologji dhe zhvillimi i fetusit (Akushi)	1.00
4.3	Gjinekologji(Praktika)	1.00
5.	Skripte interne nga ligjëratat	12
	3 lëndë x 4	12
GJITHSEJ NGA VEPRIMTARIA MËSIMORE ARSIMORE		90.4

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. Rend	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikë
1.	Punim me rezultate shkencore origjinale, i publikuar në revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen i nënshtrohen recensionit dhe të cilat kanë këshill redaktues ndërkombëtar në të cilin bëjnë pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një shtet nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve	48.00
1.1	<i>Mbrojtje e disertacionit të doktoraturës me temë ‘Identifikimi i citomegaloviruseve dhe toksoplazmave tek femrat si shkaktarë kryesor të aborteve dhe sterilitetit primar’</i> , 2022	8
1.2	<i>Hiperplazioni i zembrës së majtë me atrezion të Aortës – Medicus 2011</i>	5
1.3	<i>Big Baby Syndrome, Sfidë Akusherike – Revista Shqiptare Obstetrike dhe Gjinekologjiken 2015</i>	5
1.4	<i>Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women – 2nd International Scientific conference of the faculty of medical sciences, Health care challenges of the 21st century – 2017</i>	5
1.5	<i>Abortion rates in Tetovo region from January 2012 to June 2017; Comparative study of data from district health authorities – Universi 2017</i>	5
1.6	<i>Ndikimi i Citomegalovirusëve CMV, IgG, IgM, Toksoplazmozave TXM dhe TXG si shkaktarë potencial të sterilitetit dhe aborteve tek gratë shtatëzëna – Takim Profesional i 22 Mjekësor, 2017 Strugë</i>	5
1.7	<i>Infections during pregnancy with cytomegaloviruses – Takim Profesional i 22 Mjekësor, 2017 Strugë</i>	5
1.8	<i>Potential impact of Cytomegaloviruses CMV, IgG, IgM, Toxoplasmosis TXM and TXG as Potential Causes of Sterility and Abortion in Pregnant Women – Acta Medica Balkanika 2018</i>	5
1.9	<i>Prevalence of primary sterility and abortions as a result of viral and bacterial infections – Universi 2019</i>	5
GJITHSEJ VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE		48.00

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1.	Specializim i kryer në fushën e shkencave të mjekësisë dhe shëndetësisë	2.00
1.1	<i>Specialist Gjinekolog Akusher</i>	2.00
2.	Pozitë udhëheqëse	20.00
2.1	Kryeshef i repartit Gjinekologjisë – Akusherisë pranë Spitalit klinik Tetovë 2012 – e deri më sot	6.00
2.2	Kryetar i degës Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë të Maqedonisë, 2009-2013	4.00
2.3	Anëtar i Këshillit drejtues pranë Klinikës Universitare “Torakale” Shkup 2009-2013	3.00
2.4	Kryetar i këshillit drejtues pranë Spitalit Klinik Tetovë 2013 - 2020	2.00
2.5	Anëtar i Kuvendit, anëtar i Bordit Udhëheqës, si dhe ligjerues i akredituar për ligjerim të ndihmes së parë pranë Kryqit Kuq Tetovë; 2018 e deri më sot	2.00
2.6	Kryetar i trupit koordinues në implementimin e programës për përkujdesje perinatale 2022	3.00
3.	Konsulent i UNFPA	8.00
3.1	Pjesëmarës i projekteve të Fondit për popullatë i Kombeve të Bashkuara, prej vitit 2018, në planifikimin dhe implementimin të aktiviteteve nga Programi i UNFPA 2016-2020	2.00
3.2	Partneriteti i UNFPA me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për uljen e vdekshmërisë amtare dhe neonatale (2018), bashkëpunim ky që vetëm brenda një vitit vdekshmërinë neonatale e uli më shumë se një të tretën. D-r. Rufati është marrë me projektimin dhe kryerjen e trajnimeve, përpilimin e protokoleve republikane për kujdesin efektiv perinatal dhe antenatal, veçanërisht për pjesën që iu referua Spitalit klinik në Tetovë. Me këtë trajnim, ekipet multidisciplinore nga gjinekolog/obstetër, neonatolog dhe mami u trajnuan sipas protokoleve dhe standardeve të Organizatës Botërore Shëndetësore	2.00
3.3	Monitorimi i maternitetit për zbatimin e rekomandimeve dhe procedurave të prezantuara me trajnimin për kujdes efektiv perinatal, me qëllim promovimin e shëndetit të nënës dhe të porsalindurit (2019).	2.00
3.4	Krijimi dhe futja e një sistemi kombëtar për mbikëqyrjen dhe reagimin në obstetrikë, si pjesë iniciuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për shëndetin e nënës (2019-2020).	2.00
4.	Primarius	2.00
GJITHSEJTË NGA VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË		32.00

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR TU ZGJEDHUR NË TITULL	PIKË
VEPRIMTARIA MËSIMORE ARSIMORE	90.4
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE-	48.00
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE NGA VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	32.00
GJITHSEJ	170.40

26.12.2022, Tetovë

KOMISIONI I RECENSENTËVE

1. **Prof. Dr.Florin Besimi (kryetar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

2. **Prof. Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

3. **Doc. Dr. Merale Rexhepi (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

Deri te:
KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I
FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE
UNIVERSITETI I TETOVËS

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
MJEKËSORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës nr. **22-4380/1** të datës **14.12.2022**, dhe në bazë të konkursit të shpallur më: 16.11.2022 në gazetën ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat”, është caktuar komisioni recensues për zgjedhjen e një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Fiziologji, Të tjera (30104, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në programin studimor: mjekësi e përgjithshme, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, në përbërje me:

1. **Prof. Dr. Sheqibe Beadini (kryetar)**, profesor i rregullt në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.
2. **Prof. Dr. Beti Dejanova (anëtar)**, profesor i rregullt në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup
3. **Doc. Dr. Avdi Nazifi (anëtar)**, profesor i rregullt në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.

Komisioni i lartpërmendur pasi që i pranoi materialet e dorëzuara në konkurs, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

RAPORT

Me datë 28.11.2020 në gazetën ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” është shpallur konkurs për zgjedhje një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Fiziologji, Të tjera (30104, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në programin studimor: mjekësi e përgjithshme, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës.

Komisioni në fjalë, pasi kontrolloi materialet e dorëzuara, konstatoi se në konkurs është paraqitur një kandidat, edhe atë:

1. **Dr.sci Vegim Zhaku**

TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Vegim Zhaku, u lind më 11.04.1990 në Strugë. Shkollën fillore e kreu pranë SH.F Naim Frashëri në vendlindjen Dollogozhdë, kurse të mesmen në drejtimin e gjimnazit të përgjithshëm në Sh.M.K “D-r Ibrahim Temo”, Strugë.

Në vitin 2008 regjistrohet si gjeneratë e parë e studentëve të mjekësisë së përgjithshme pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës të cilin e kreu në afatin e paraparë në vitin 2014 dhe ishte një nga 3 studentët e parë të diplomuar, me mesatare 9.34.

Gjatë kohës si student u angazhua edhe në aktivitete ekstrakurrikulare me grupin shkencor por edhe me disa organizata joqeveritare, si koordinatori i aktiviteteve për shënimin e ditëve botërore të shëndetësisë si dhe pjesëmarrje nëpër konferenca të ndryshme mjekësore, duke u laureuar me çmime të ndryshme në kongrese me pjesëmarrje ndërkombëtare. Si rezultat i angazhimit maksimal në aktivitetet studentore por edhe si rezultat i suksesit në studime, në vitin 2013 do të zgjidhej si student i dalluar i Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës nga Forumi Rinor Islam me rastin e manifestimit të vitit të ri Hixhri 1435.

Në vitin 2014, angazhohet si asistent i Fiziologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në drejtimin e mjekësisë së përgjithshme.

Në vitin 2015 do të angazhohet si mjek i praksës së përgjithëshme në kuadër të sektorit primar shëndetësor në Strugë duke shërbyer për 5 vite deri në vitin 2020 dhe duke mbuluar disa zona rurale të rajonit.

Në vitin 2016 regjistron studimet e ciklit të tretë, në drejtimin Biomedicinë pranë Universitetit të Tetovës. Në të njëjtin vit zgjidhet pjesë e bordit drejtues të filjalës së IPPNW (International Physicians for Preventing Nuclear War) në Shkup, shoqatë me qendër në Boston, SHBA.

Në vitin 2019 regjistron specializimin në fushën e Kardiologjisë pranë Universitetit Shën Kirilli dhe Metodi në Shkup.

Në vitin 2020 nga bordi mësimor shkencor zgjidhet asistent i rregullt në fakultetin e shkencave mjekësore në UT.

Në Mars të vitit 2021 emërohet përgjegjës i programit studimor të mjekësisë së përgjithshme pranë FSHM-UT, pozitë të cilën e mban edhe aktualisht.

Në Shtator të vitit 2022, mbrojti me sukses disertacionin e doktoraturës me titull “Roli i antioksidantëve në reduktimin e stresit oksidativ dhe përmirësimin e parametrave spermatikë tek meshkujt me oligoastenoteratozoospermi”, drejtimi Biomedicinë, në fakultetin e shkencave mjekësore, pranë Universitetit të Tetovës, dhe merr titullin doktor i shkencave nga fusha e shkencave mjekësore - lëmia biomedicinë.

Gjatë periudhës studentore por edhe pas saj ka bërë disa trajnime mjekësore në universitete dhe institucione shëndetësore si: në Institutin e Anatomisë në Universitetin Mjekësor të Graz-it - Austri, Institutin e Fiziologjisë dhe patofiziologjisë në Universitetin e Trakyas - Turqi, në departamentin e mjekësisë interne dhe kirurgjisë në klinikën e Wurzburg-ut - Gjermani, në Cleveland Clinic (Andrology center), Ohio – SHBA dhe Salzburg Weill Cornell - Austri.

Zotëron disa gjuhë të huaja si: anglisht (niveli lartë), maqedonisht (niveli lartë), frëngjisht (niveli mesatar), sërbo-kroatisht (niveli mesatar) dhe turqisht (niveli bazik).

VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

Dr. sci Vegim Zhaku në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës mban ushtrime në lëndën: *Fiziologji I* dhe *Fiziologji II* në programin studimor mjekësi e përgjithshme; ligjerata në lëndën *Radiologji* në drejtimit mjekësi e përgjithshme dhe fizioterapi, si dhe ligjerata nga lënda *Fiziologji me Anatomi funksionale* në drejtimin edukim special dhe rehabilitim, fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr. sci Vegim Zhaku ka realizuar gjithsej 143,15 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr. sci Vegim Zhaku ka realizuar gjithsej 155.4 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr. sci Vegim Zhaku në këtë veprimtari ka grumbulluar 10 pikë.

VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr. sci Vegim Zhaku në këtë veprimtari ka grumbulluar 13 pikë.

FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore të kandidatit Dr.sci Vegim Zhaku i cili ka grumbulluar gjithsej **321,55 pikë**.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKË
VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE	143,15
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	155,4
VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE	10
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË	13
GJITHSEJ	321,55

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Dr.sci Vegim Zhaku në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsej **321,55 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore: **Docent**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni Recensues konstaton se: Dr.sci Vegim Zhaku posedon cilësi shkencore-profesionale dhe në bazë të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë Veriore, në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ai i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, që kandidati **Dr.sci Vegim Zhaku** të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore: **Docent** për lëndët mësimore **Fiziologji, Të tjera** (30104, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, 2022

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Sheqibe Beadini (kryetar)

2. Prof. Dr. Beti Dejanova (anëtar)

3. Doc.Dr. Avdi Nazifi (anëtar)

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: Vegim Selami Zhaku

Institucioni: Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lëmia shkencore: Fiziologji, të tjera (30104, 30118 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR – DOCENT / TITULLIN SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR SHKENCOR

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,34 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 9,34	po
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha e shkencave mjekësore Emri i sferës shkencore: Biomedicinë	po
3	Të publikuara së paku katër punime shkencore* në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje.	po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3.1	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime shkencore të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, e cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit të lartë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: JHED - Journal of Hygienic Engineering and Design 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Scopus 3. Titulli i punimit: “Combination of Maca, Korean ginseng extract and anioxidant therapy for male with oligoasthenozoospermia: case study” 4. Data e publikimit: Mars, 2019 	po
3.2	<ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: Acta Medica Balkanica Interantional Journal of Medical Sciences - AMBIJMS 2. Emri i bazës elektronike të revistave: ISI Impact Factor (IIF) – 0,0116, Google Scholar, Index Copernicus, EBSCO 3. Titulli i punimit: “Role of antioxidants in the diminuiton of oxidative stress and amelioration of semen parameters in idiopathic male infertility” 4. Data e publikimit: Prill, 2020 	po
3.3	<ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: IntechOpen 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Clarivate Web of Science – Book Citation Index, Google Scholar, British Library, Crossref, EBSCOhost 3. Titulli i punimit: <i>Open access peer-reviewed chapter: Male Infertility, Oxidative Stress and Antioxidants.</i> IntechOpen book series Chapter published in the book entitled: <i>“ Vitamin E in Health and Disease - Interactions, Diseases and Health Aspects, Pinar Erkekoglu and Júlia Scherer Santos”</i>. 4. Data e publikimit: 6 Tetor, 2021 	po

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3.4	<ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: Acta Medica Balkanica Interantional Journal of Medical Sciences - AMBIJMS 2. Emri i bazës elektronike të revistave: ISI Impact Factor (IIF) – 0,0116, Google Scholar, Index Copernicus, EBSCO 3. Titulli i punimit: “Efficacy and rationale behind combination of antioxidant therapy in men with oligoastenozoospermia and elevated caspase-3 activity” 4. Data e publikimit: Shtator, 2022 	po
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certificate of English language 3. Dhënësi i dokumentit: SH.G “Aureola” 4. Data e dhënies së dokumentit: Korrik, 2016 	po
5	<p>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë – Universiteti i Tetovës 2. Lloji i trajnimit/ përvoja /arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: Puntori, konferenca, simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare prej vitit 2014 e në vazhdim. 3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: Prej vitit 2014 (9 vite). 	po

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: Vegim Selami Zhaku

Institucioni: Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lëmia shkencore: Mjekësi e Përgjithshme

VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Kalkulimi	Pikët
1	Mbajtja e ushtrimeve dhe ligjëratave në ciklin e parë të studimeve		125,55
1.1	Viti akademik 2014/2015- semestri dimëror Fiziologji I (Mjekësi e Përgjithshme)	32x15x0.03	14.4
1.2	Viti akademik 2014/2015- semestri veror Fiziologji II (Mjekësi e Përgjithshme)	24x15x0.03	10.8
1.3	Viti akademik 2015/2016- semestri dimëror Fiziologji I (Mjekësi e Përgjithshme)	20x15x0.03	9
1.4	Viti akademik 2015/2016- semestri veror Fiziologji II (Mjekësi e Përgjithshme)	15x15x0.03	6.75
1.5	Viti akademik 2016/2017-semestri dimëror Fiziologji I (Mjekësi e Përgjithshme)	16x15x0.03	7.2
1.6	Viti akademik 2016/2017-semestri veror Fiziologji II (Mjekësi e Përgjithshme)	12x15x0.03	5.4
